

## **Komuna e Ranillugut: problemet kryesore dhe trendët buxhetor**

### **Hyrje**

- 1.** Komuna e Ranillugut banohet kryesisht nga komuniteti serb. Kjo Komunë është formuar nga territori i Komunës së Kamenicës, me ç'rast është marrë 15% e territorit të kësaj komune. Ranillugu shtrihet në pjesën lindore të Kosovës, me sipërfaqe prej 74.3 km katrorë dhe popullsi prej 3.886 banorësh. Mbi 95% e popullsisë janë serb dhe 4% janë shqiptarë. Ranillugu ka 13 fshatra serbe dhe tri lagje të vogla të banuara me shqiptarë. Administrata e komunës numëron 50 të punësuar, prej të cilëve tetë janë shqiptarë dhe 42 serb.
- 2.** Kryetar i Komunës së Ranillugut është Gradimir Mikic nga partia “Iniciativa Qytetare për Komunën e Ranillugut”, e cila në zgjedhjet e nëntorit 2009 ka marrë 11 ulëse në Kuvendin e Komunës, e pasuar nga “Partia e Serbeve të Kosovës dhe Metohisë”, e cila ka fituar katër ulëse në Kuvend dhe e cila mban edhe pozitën e nënkryetarit të komunës.
- 3.** Kuvendi i Komunës së Ranillugut numëron 15 anëtarë, kurse numri i drejtorive komunale është gjashtë. Gradimir Mikic, para se të zgjidhej kryetar i Ranillugut për dy vite (2007-2009) ka qenë nënkryetar i Komunës së Kamenicës.
- 4.** Komuna e Ranillugut ka marrë këtë emërtim për shkak të fshatit më të madh të banuar me serbë, por administrata komunale e kësaj komune të re nuk gjendet në Ranillug por është e shpërndarë në Domaroc dhe Ropotovë. Administrata komunale nuk është vendosur në fshatin Ranillug për shkak të kundërshtimit të serbëve dhe strukturave paralele të cilat ende mbështeten nga Qeveria e Serbisë.
- 5.** Ne bazë të një hulumtimi të DEMI/USAID vetëm 51% e qytetarëve të kësaj komune janë shprehur të kënaqur me punën e Kryetarit

të Komunës, dhe vetëm 43% e qytetarëve janë shprehur të kënaqur me punën e me administratës komunale.<sup>1</sup>

## Problemet kryesore të Komunës së Ranillugut

- 1. Infrastruktura në fshatin Domoroc.** Fshati Domoroc është fshati më lindor i Komunës së Ranillugut. Në këtë fshat është e vendosur një pjesë e administratës komunale. Rrugët e asfaltuara para shumë vitesh në brendi të fshatit Domoroc janë dëmtuar. Disa nga to madje janë të dëmtuara as shumë sa vështirë kalohet me automjete. Përveç rrugëve të dëmtuara, shqetësim paraqet edhe mungesa e rrjetit të kanalizimit. Për shkak se fshati gjendet në hapësirë të pjerrët gjeografike, pas reshjeve të shiut rrugët vërshohen nga ujërat. Rrjedha e ujit është një nga shkaktarët kryesor të prishjes së rrugëve të asfaltuara, në mungesë të kanaleve atmosferike për bartjen e ujërave.
- 2. Rrugët e dëmtuara.** Pothuajse të gjitha lokalitetet në Komunën e Ranillugut kanë rrugë të asfaltuara. Këto rrugë janë asfaltuar shumë vite më parë dhe shumica nga to janë dëmtuar në masë të madhe. Përveç rrugicave të dëmtuara në brendi të fshatit Domoroc, edhe rrugët lokale që të shpiejn në fshatrat Domoroc dhe Ropotovë e Vogël janë dëmtuar dhe në to janë hapur gropa të shumta. Rruga është mjaftë e dëmtuar edhe në hyrje të fshatit Ropotovë e Madhe.
- 3. Mungesa e ujit të pijes.** Vetëm rreth 30% e hapësirës në komunën e Ranillugut mbulohet me rrjet të ujësjellësit publik. Banorët tjerë kryesisht furnizohen me ujë nga puset.<sup>2</sup> Gjendja me e keqe nga mungesa e ujit të pijes paraqitet në zonën e quajtur Bozhec, Hodec, Tomanc dhe Ropotovë e Vogël. Gjendje jo e mirë me furnizim me ujë të pijes gjendet edhe në “Lagjen e Dubovë”, në të cilën mungon ujësjellësi, kurse viteve të fundit banorët janë përballur edhe me shterjen e puseve të ujit. Banorët nuk kanë mundësi financiare që secili prej tyre të bëjnë shpimin e puseve për ujë, ngase këto investime janë të kushtueshme. Hulumtimi i UNDP-së i 2012 i cili bazohet në opinionin e qytetarëve nxjerr në pah se banorët e Komunës së Ranillugut, përkatësisht 52% e tyre janë deklaruar se nuk kanë ndërprerje të ujit të pijes, 22% kanë

<sup>1</sup> Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 14. Burimi: [http://www.demiks.org/repository/docs/Citizen\\_Satisfaction\\_Report-Shqip.pdf](http://www.demiks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf)

<sup>2</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 135. Burimi: [http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo\\_Mosaic\\_2012\\_Alb\\_216825.pdf](http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf)

ndërprerje prej 1 deri në 4 orë gjatë ditës, 15% nga 5 deri në 10 orë në ditë, ndërsa 7% kanë ndërprerje më shumë se 11 orë në ditë.<sup>3</sup>

**4. Mungesa e kanalizimeve.** Ranillugu është një komunë rurale, ku fshatrat janë të shpërndara larg njëri tjetrit. Në këtë mënyrë, është problematike dhe e kushtueshme që të instalohet rrjet i integruar i kanalizimeve. Por, në disa lokalitete, kanalizimet paraqesin mjaft probleme. Në fshatin Domoroc, gypat e kanalizimit ekzistues janë mbyllur nga reshjet e shiut dhe kanalizimi ekzistues është jo funksional. Kanalizimet mungojnë edhe në fshatrat Bozhec, Drenoc, Rajanoc dhe në “Lagjen e Dubove”. Nga hulumtimi i realizuar USAID/DEMI të rasti i Komunës së Ranillugut tregohet se afro 38% e qytetarëve të kësaj komune nuk janë të kënaqur me mënyrën e funksionimit të sistemit të kanalizimeve në qytetin apo vendbanimin e tyre.<sup>4</sup>

**5. Mungesa e fushave të sportit në Kodrën e Përlepnicës, Lagjen e Dubove, Bozhec.** Komuna e Ranillugut ka ndërtuar fushën e futbollit të vogël në fshatin Ranillug. Kanë filluar punimet në ndërtimin e fushës së tenisit në fshatin Glllogoc.<sup>5</sup> Po ashtu janë filluar punët në ndërtimin e fushës së sportit në Ropotovë të Madhe (dhjetor 2012<sup>6</sup>), por ende nuk janë përfunduar. Në fshatin Domoroc fusha e futbollit dhe basketbollit janë ndërtuar para shumë vitesh dhe janë në gjendje të mirë. Por edhe banorët e “Kodrës së Përlepnicës”, “Lagjen e Dubove”, fshatin Bozhec, kërkojnë ndërtimin e terreneve sportive. Nga hulumtimi i realizuar USAID/DEMI të rasti i Komunës së Ranillugut tregohet se afro 55% e qytetarëve janë të pakënaqur me kushtet dhe aktivitetet sportive në komunën e tyre, përqindje e njëjtë e të pakënaqurve haset edhe për aktivitetet dhe kushtet rinore dhe atyre kulturore në Komunën e Ranillugut.<sup>7</sup>

**6. Mungesa e trotuareve dhe e disa rrugëve të rregulluara.** Pjesa dërmuese e rrugëve të rregulluara nëpër fshatra si dhe në vetë vendbanimin e Ranillugut nuk kanë trotuar. Si pasojë e kësaj kanë

<sup>3</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 135. Burimi:[http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo\\_Mosaic\\_2012\\_Allb\\_216825.pdf](http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Allb_216825.pdf)

<sup>4</sup> Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 21. Burimi: [http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen\\_Satisfaction\\_Report-Shqip.pdf](http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf)

<sup>5</sup> Komuna e Ranillugut. Lajmi zyrtar. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/ranillug/News/Ndertimi-i-terreneve-sportive.aspx>

<sup>6</sup> KRPP Njoftimi për dhënie të tenderit për rregullimin e fushës së sportit në Ropotovë të Madhe: <http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=65367>

<sup>7</sup> Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 31. Burimi: [http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen\\_Satisfaction\\_Report-Shqip.pdf](http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf)

ndodhur disa aksidente me ç'rast këmbësoret janë goditur nga veturat. Gjendja më e keqe është në fshatin Domoroc, Pançellë dhe Ropotovë e Vogël. Në bazë të hulumtimit të DEMI/USAID, vetëm 43% e qytetarëve në Komunën e Ranillugut janë të pakënaqur me gjendjen e rrugëve në vendbanimet e tyre, përderisa kjo përqindje shkon në 59% jo të kënaqur me trotuaret në komunën e tyre.<sup>8</sup> Në Ranillug hasen rrugë akoma të parregulluara siç është ajo e Drenocit.

## Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur

- 1. Parku në Ranillug.** Komuna e Ranillugut aktualisht vlerësohet të këtë një park atraktiv në qendër të Ranillugut i cili nga qytetarët është kërkuar të mirëmbahet dhe mos të lejohet hapja e lokaleve hoteliere në afërsi të tij. Qytetarët kanë kërkuar investime në këtë park, veçmas në shtimin e numrit të ulëseve, forcimin dhe zgjerimin e rrjetit të ndriçimit gjatë natës, shtimin e shportave për hedhjen e mbeturinave të imta si dhe caktimin e disa personave për ruajtjen e parkut dhe mirëmbajtjen e tij.
- 2. Tokat bujqësore.** Njëra nga gjerrat që është sugjeruar nga njohësit e rrethanave në Ranillug të ruhet është edhe tokat bujqësore. Sipas tyre tokat bujqësore nuk ruhen dhe ju janë ekspozuar ndërtimeve të ndryshme të vrazhda të cilat e pakësojnë dhe e dëmtojnë tokën bujqësore.


## Trendët Buxhetore në Komunën e Ranillugut

Komuna e Ranillugut është planifikuar t'i ketë 1.1 milionë euro buxhet në vitin 2013. Krahasuar me vitin 2010 buxheti i kësaj komunë ka pësuar rënie prej 200 mijë euro apo 15%. Në anën tjetër, të hyrat vetanake janë rritur në mënyrë graduale që nga viti 2010 dhe në vitin 2012 ato kanë shënuar gjithsejtë 80 mijë euro. Në vitin 2013, të hyrat vetanake planifikohet të jenë gjithashtu 80 mijë euro.

---

<sup>8</sup> Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 29. Burimi: [http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen\\_Satisfaction\\_Report-Shqip.pdf](http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf)


Figura 1. Buxheti i Komunës së Ranillugut 2013



Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?ranillug/2010#/~~/ranillug>

Një gjë që bie në pah tek trendet e ndarjeve buxhetore (figura 2) është se investimet kapitale kanë pësuar një rënie të theksueshme prej 533 mije euro apo 74% krahasuar vitin 2012 me vitin 2010. Në vazhdim, derisa në vitin 2010 Pagat dhe Mëditjet përbënin 39% të shpenzimeve, në vitin 2013 ato përbëjnë 69% të shpenzimeve.

Figure 1. Trendet e Ndarjeve Buxhetore



Disa nga rekomandimet e raportit të auditorit<sup>9</sup> janë: a) deponimi i mjeteve me kohë në llogarinë bankare; b) të krijojë komitetin e auditimit; c) para se të bëhet procedurat e prokurimit duhet të zotohen fondet.

<sup>9</sup> ZAP, Raporti i Auditimit mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Ranillugut e Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013, [http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KRL\\_2012\\_Shqip\\_620264.pdf](http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KRL_2012_Shqip_620264.pdf)

Komuna e Ranillugut planifikon një rritje të theksuar të buxhetit në tri vitet e ardhshme dhe kjo kryesisht nga vlerësimet e rritjes së grantit qeveritar. Në anën tjetër, kategoritë që vlerësohet të përfitojnë më së shumti nga kjo rritje buxhetit janë: pagat dhe mëditjet dhe investimet kapitale.

Tabela 1. Të hyrat dhe Shpenzimet 2014-2016

	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
<b>Të Hyrat Totale</b>	<b>1.142.061</b>	<b>1.169.813</b>	<b>1.194.846</b>
Granti Qeveritar	1.058.061	1.083.293	1.106.596
Të hyrat vetanake	84.000	86.520	88.250
<b>Shpenzimet Totale</b>	<b>1.142.057</b>	<b>1.169.813</b>	<b>1.194.846</b>
Paga dhe Mëditje	825.860	827.864	827.864
Mallra dhe Shërbime	96.629	98.000	99.000
Shpenzimet Komunale	42.000	42.000	42.500
Subvencionet dhe	31.000	31.000	31.000
Investime kapitale	146.568	170.949	194.482

## **Metodologjia e hartimit të raportit**

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuuese dhe analitike, janë grumbulluar informata të shumta për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Ranillugut është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruara përmes anketës së zhvilluar nga UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).





Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.